



“41/1. Në rast të mosparaqitjes së nëpunësit civil brenda afatit të përcaktuar në pikën 41, të kreut III, të këtij vendimi, institucioni, ku nëpunësi është emëruar, njofton njësinë përgjegjëse brenda 5 (pesë) ditëve pune nga përfundimi i afatit. Në këtë rast njësinë përgjegjëse vijon procedurën me anulimin e aktit administrativ (akti i emërimit), në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

41/2. Institucioni, ku nëpunësi civil është emëruar nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, detyrohet të nxjerrë aktin e fillimit të efekteve financiare jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e paraqitjes së nëpunësit në institucion. Këto afate mund të shtyhen me marrëveshje ndërmjet dy palëve, por jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e nxjerrjes së aktit të emërimit nga njësinë përgjegjëse.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2019.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Senida Mesi

**VENDIM**  
Nr. 750, datë 19.12.2018

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 933, DATË 2.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRFAQËSIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME ME OFICERË KONTAKTI NË BRITANINË E MADHE, BELGJIKË, ITALI, GREQI, TURQI, KOSOVË, SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS, GJERMANI, FRANCË, EUROPOL DHE INTERPOL”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 84, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 933, datë 2.7.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti në shtete të ndryshme dhe në organizata ndërkombëtare”.

Faqe | 14054

b) Në pikën 1, pas shtetit “Francë” shtohen shtetet “Holandë dhe Spanjë”.

2. Efektet financiare të këtij vendimi të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Brendshme, programi buxhetor “Policia e Shtetit”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Senida Mesi

**VENDIM**  
Nr. 751, datë 19.12.2018

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 910, DATË 21.12.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ÇËSHTJET, OBJEKT KONSULTIMI, DHE STRUKTURËN, PROCEDURËN, FORMËN, MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KONSULTATIV TË QEVERISJES QENDRORE ME VETËQEVERISJEN VENDORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 910, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shitesat, si më poshtë vijon:

1. Pika 7, e kreut III, “Krijimi, përbërja dhe drejtimi i Këshillit Konsultativ”, ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“7. Përbërja e Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore është në përfaqësim të barabartë anëtarësh, 9 (nëntë) përfaqësues të qeverisjes qendrore dhe 9 (nëntë) përfaqësues të vetëqeverisjes vendore, si më poshtë vijon:

- Zëvendësministri përgjegjës për çështjet vendore, rendin dhe sigurinë;

- Zëvendësministri përgjegjës për fushën e financave;

- Zëvendësministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë;

- Zëvendësministri përgjegjës për energjinë dhe infrastrukturën;



- Zëvendësministri përgjegjës për çështjet sociale;

- Zëvendësministri përgjegjës për integrimin evropian;

- Zëvendësministri përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural;

- Zëvendësministri përgjegjës për mjedisin dhe turizmin;

- Zëvendësministri përgjegjës për arsimin;

- Kryetari i Shoqatës për Autonominë Vendore dhe 2 kryetarë bashkie, përfaqësues të Shoqatës për Autonomi Vendore;

- Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë dhe 2 kryetarë bashkie, përfaqësues të Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë;

- Kryetari i Shoqatës së Qarqeve dhe 2 kryetarë qarku, përfaqësues të Shoqatës së Qarqeve.”

2. Pas pikës 17, të kreut IV, “Procedura e konsultimit të akteve dhe mbledhjet e Këshillit”, shtohet pika 17/1, me këtë përmbajtje:

“17/1. Mbledhjet e punës dhe mbledhjet plenare të Këshillit zhvillohen në prani të më shumë se gjysmës të të gjithë anëtarëve të tij. Për mospjesëmarrjen e anëtarëve njoftohen titullarët e institucioneve të përfaqësuara në Këshillin Konsultativ.”

3. Në pikën 26, të kreut V, “Sekretariati teknik”, emërtimi “Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale” zëvendësohet me “Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore” dhe shkurtimi “AZRT” zëvendësohet me “AMVV”.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Senida Mesi

## VENDIM

Nr. 752, datë 19.12.2018

### PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT, FUNKSIONIMIT DHE PËRCAKTIMIT TË MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË BORDIT TË APELIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 5 e 7, të nenit 193/b, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore së organizimit, funksionimit dhe përcaktimit të masës së shpërblimit të anëtarëve të bordit të apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare që lindin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë pas botimit të tij në “Fletoren zyrtare”.

3. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Senida Mesi

#### RREGULLORE

### E ORGANIZIMIT, FUNKSIONIMIT DHE PËRCAKTIMIT TË MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË BORDIT TË APELIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

Neni 1  
Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe të procedurave lidhur me organizimin, funksionimin dhe përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të bordit të apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.